



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 56, datë 13.07.2005

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI TRANSAKSIONET E SHITBJEREVE ME TË DREJTA TË PLOTA”**

Në mbështetje të neneve 1,14,15,16,18, si dhe nenit 43, shkronjat (a) dhe (c) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota”, sipas tekstit që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare, për zbatimin e këtij vendimi dhe për dërgimin e kësaj rregulloreje në bankat e nivelit të dytë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

RREGULLORE MBI TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE

ME TË DREJTA TË PLOTA

Transaksionet outright (letrat me vlerë)

KAPITULLI I

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Transaksionet shitje-blerje me të drejta të plota në tregun e hapur i referohen operacioneve të Bankës së Shqipërisë për shitblerjen me të drejta të plota në treg:

- të bonove të thesarit me afat maturimi deri një vit dhe me periudhë të mbetur në maturim jo më pak se shtatë ditë;

- të letrave të tjera me vlerë, të cilat duhet të jenë instrumente borxhi, të kenë kredibilitet të lartë, të jenë të formës *book-entry*, e që bëhen objekt i këtyre transaksioneve me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

(2) Këto operacione ekzekutohen me qëllim të administrimit të likuiditeteve dhe të normave të interesit. Transaksionet me të drejta të plota mund të marrin formën e shtimit të likuiditetit, në rastin e blerjeve me të drejta të plota ose të pakësimit të likuiditetit, në rastin e shitjeve me të drejta të plota.

Neni 2

Një transaksion me të drejta të plota përfaqëson transferimin e plotë të të drejtës së pronësisë nga shitësi tek blerësi. Në këtë rast, nuk kemi transaksionin e anasjelltë.

KAPITULLI II

PROCEDURA E TRANSAKSIONIT

Neni 3

Banka e Shqipërisë hyn në transaksione shitblerjeje me të drejta të plota vetëm me bankat e nivelit të dytë që kanë llogari pranë saj.

Neni 4

Këto transaksione realizohen me vendim të Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë. Transaksionet e shitblerjeve kanë frekuencë të papërcaktuar.

Neni 5

Operacionet me të drejta të plota ekzekutohen nëpërmjet ankandeve të shpejta ose nëpërmjet procedurave dypalëshe. Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë miraton formën e kryerjes së transaksionit.

Neni 6

Në rastin e kryerjes së transaksioneve me ankande të shpejta, Banka e Shqipërisë njofton me SWIFT, me teleks, me faks, nëpërmjet sistemit REUTERS apo me shkresë zyrtare të gjitha bankat e nivelit të dytë për organizimin e tyre.

Njoftimi përmban informacionin si më poshtë:

- numrin referues të ankandit;
- tipin e ankandit (shitje ose blerje);
- datën dhe orën e mbajtjes së ankandit;
- vlerën nominale të bonove të thesarit që ofrohet/kërkohe për t'u shitur/blerë;
- afatin e maturimit.

Neni 7

Brenda dy orësh nga momenti i njoftimit, bankat e nivelit të dytë i konfirmojnë Bankës së Shqipërisë pjesëmarrjen e tyre në ankand.

Konfirmimi përmban:

- numrin referues të ankandit;
- tipin e ankandit (nga këndvështrimi i Bankës së Shqipërisë);
- datën dhe orën e mbajtjes së ankandit;
- vlerën nominale të bonove të thesarit që kërkohe/ofrohe në ankand;
- çmimin e blerjes/shitjes së bonove të thesarit që kërkohe/ofrohe;
- afatin e maturimit;
- emrin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar nga banka e nivelit të dytë.

Neni 8

(1) Nëse Banka e Shqipërisë organizon ankand për shitjen/blerjen e bonove të thesarit, atëherë, kërkesat e paraqitura do të renditen sipas rendit zbritës/rritës të çmimit.

(2) Fitues në ankand konsiderohen të gjithë pjesëmarrësit deri në plotësimin e vlerës nominale të ofruar/kërkuar nga Banka e Shqipërisë.

(3) Nëse dy ose më shumë pjesëmarrës në ankand ofrojnë me kushte të njëjta, atëherë, kërkesat e tyre plotësohen pjesërisht sipas mekanizmit *pro-rata*.

Neni 9

Ankandi do të zhvillohet nga Komisioni i Ankandit, i cili përbëhet nga një përfaqësues i Departamentit të Operacioneve Monetare dhe një përfaqësues i Departamentit të Politikës Monetare. Në rast se njëri nga anëtarët nuk është i pranishëm, atëherë, ai zëvendësohet me një anëtar të departamentit përkatës.

Vendimi përfundimtar për rezultatin e ankandit merret nga Drejtori i Operacioneve Monetare mbi bazën e materialit të përgatitur nga komisioni. Në mungesë të Drejtorit vendimi merret nga Zëvendësdrejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare.

Neni 10

Menjëherë pas përfundimit të ankandit, Banka e Shqipërisë njofton pjesëmarrësit mbi rezultatet e tij me një nga mjetet e komunikimit si më lart.

Neni 11

Në rastin e kryerjes së transaksioneve të shitblerjeve të bonove të thesarit me të drejta të plota, nëpërmjet procedurave dypalëshe, Banka e Shqipërisë, njofton me SWIFT, faks, teleks, REUTERS bankën me të cilën synon të operojë.

Nëse banka e nivelit të dytë bie dakord të hyjë në transaksion ajo i dërgon menjëherë konfirmimin Bankës së Shqipërisë. Pas këtij veprimi të dyja palët përcaktojnë termat e transaksionit.

KAPITULLI III**PASTRIMI, RREGULLIMI I LLOGARIVE, RREGJISTRI I BONOVE TË THESARIT****Neni 12**

Transaksionet për shitblerjen e bonove të thesarit me të drejta të plota pastrohen dhe rregullohen në të njëjtën ditë me atë të zhvillimit të ankandit apo të përfundimit të transaksionit dypalësh.

Neni 13

Me përfundimin e transaksionit, bazuar në parimin "dorëzim kundrejt pagesës" (DVP), bëhet transferimi i pronësisë së letrave me vlerë dhe njëkohësisht lëvizja e fondeve në llogaritë përkatëse.

Neni 14

Kjo rregullore miratohet me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.56, datë 13.07.2005 dhe hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 15

Me miratimin e kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja "Mbi transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota" miratuar me vendim nr.08, datë 07.02.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Ardian FULLANI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 57, datë 13.07.2005

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KREDINË LOMBARD”**

Në mbështetje të neneve 1,14,15,16,18, si dhe nenit 43, shkronjat (a) dhe (c) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për kredinë lombard”, sipas tekstit që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare, për zbatimin e këtij vendimi dhe për dërgimin e kësaj rregulloreje në bankat e nivelit të dytë
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**RREGULLORE
PËR KREDINË LOMBARD**

Neni 1

Qëllimi i kredisë lombard është plotësimi i nevojave afatshkurtra për likuiditet të bankave të nivelit të dytë. Ajo përfaqëson instrumentin më të fundit kreditues për sistemin bankar. Kredia lombard është kredia më e shtrenjtë në dispozicion të bankave të nivelit të dytë.

Neni 2

Banka e Shqipërisë do t'i akordojë kredi lombard çdo banke që konstatohet të ketë mungesë likuiditeti por që është financiarisht e qëndrueshme.

Neni 3

Çdo bankë që paraqitet me mungesë likuiditeti, duhet të shfrytëzojë të gjitha burimet e mundshme të likuiditetit përpara se të aplikojë për kredi lombard në Bankën e Shqipërisë.

Neni 4

Çdo bankë që përmbush kriteret e përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje është e detyruar që t'i paraqesë Bankës së Shqipërisë, së bashku me kërkesën për kredi lombard, dokumentet e mëposhtme:

- (a) një raport mbi gjendjen e likuiditetit dhe shkaqet e mungesës së likuiditetit;
- (b) listë të detajuar të veprimeve të ndërmarra në përputhje me zbatimin e nenit 3 të kësaj rregulloreje;
- (c) një listë të garancive që do të paraqesë në Bankën e Shqipërisë për sigurimin e kredisë;
- (d) një plan veprimi për daljen nga situata e mungesës së likuiditetit; dhe
- (e) një projektplan të lëvizjes së fondeve gjatë kohës së shfrytëzimit të kredisë lombard.

Neni 5

Kredia lombard është kredi plotësisht e garantuar, ku si mjet për garantimin e detyrimit shërbejnë vlerat e përcaktuara si të tilla në rregulloren " Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.107, datë 24.12.2003.

Neni 6

Çdo bankë e nivelit të dytë ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kredi lombard për shumën më të madhe midis 20 për qind të kapitalit të paguar dhe 2 për qind të depozitave në lekë, sipas gjendjes më të fundit të paraqitur nga Banka e Shqipërisë.

Neni 7

Çdo bankë e nivelit të dytë mund ta shfrytëzojë kredinë lombard për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj. Kërkesa për kredi lombard mund të bëhet vetëm një herë në çdo tremujor.

Neni 8

(1) Interesi i kredisë lombard është 6 për qind, me bazë vjetore, më i lartë së interesi i marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor, që përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

(2) Banka e Shqipërisë njofton menjëherë bankat për çdo ndryshim të normës së interesit.

Neni 9

Kredia lombard miratohet pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga banka sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje. Kredia lombard miratohet nga Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë.

Neni 10

(1) Kredia lombard akordohet ditën e miratimit të saj. Banka e Shqipërisë transferon fondet në llogarinë e bankës së nivelit të dytë. Banka e nivelit të dytë transferon pranë Bankës së Shqipërisë garancinë e kredisë lombard në përputhje me rregulloren "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë".

(2) Në ditën e maturimit të kredisë, të përcaktuar sipas kërkesës së bankës dhe të miratuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje, banka e nivelit të dytë shlyen kredinë lombard së bashku me interesin.

(3) Me shlyerjen e kredisë lombard, bankës kredimarrëse i kthehet garancia e kredisë.

Neni 11

(1) Në qoftë se kredia lombard nuk kthehet në datën e maturimit, Banka e Shqipërisë do të veprojë sipas rregullores "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.107, datë 24.12.2003.

(2) Në rast se banka nuk e kthen kredinë lombard në përfundim të afatit të përcaktuar, atëherë asaj nuk do t'i lejohet akordimi i asnjë lloj tjetër kredie në tremujorin pasardhës.

Neni 12

Për çdo rast të akordimit të kredisë lombard, Departamenti i Operacioneve Monetare njofton Departamentin e Mbikëqyrjes. Departamenti i Mbikëqyrjes mbikëqyr përdorimin e kredisë lombard nga banka e nivelit të dytë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Kjo rregullore miratohet me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.57, datë 13.07.2005 dhe hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 14

Me miratimin e kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja "Për kredinë lombard" miratuar me vendim nr.08, datë 07.02.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Ardian FULLANI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.58, datë 13.07.2005

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR DEPOZITËN NJËDITORE”**

Në mbështetje të neneve 1,14,15,16,18, si dhe nenit 43, shkronjat (a) dhe (c) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për depozitën njëditore”, sipas tekstit që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare, për zbatimin e këtij vendimi dhe për dërgimin e kësaj rregulloreje në bankat e nivelit të dytë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Vendimi nr.92, datë 12.11.2003 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e një ndryshimi në rregulloren “Për instrumentet indirekte të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë”, shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**RREGULLORE
PËR DEPOZITËN NJËDITORE**

Neni 1

Depozita njëditore përfaqëson një instrument afatshkurtër investimi për bankat e nivelit të dytë. Ajo ka për qëllim rregullimin e nivelit të likuiditetit në sistemin bankar dhe stabilizimin e normave të interesit në tregun e parasë.

Neni 2

Depozitë në Bankën e Shqipërisë mund të vendosin të gjitha bankat dhe degët e bankave që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri dhe që mbajnë llogari pranë Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Shuma në lekë e depozitës që një bankë e nivelit të dytë kërkon të vendosë pranë Bankës së Shqipërisë është e pakufizuar.

Banka e Shqipërisë mund të refuzojë kërkesën e bankave të nivelit të dytë për vendosje depozite pranë Bankës së Shqipërisë në përputhje me synimet e saj, pa dhënë shpjegime.

Neni 4

(1) Norma e interesit të depozitave të bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë sinjalizon nivelin e dëshirueshëm dysheme të normave afatshkurtra të interesit.

(2) Norma e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke të nivelit të dytë për depozitën njëditore është 1.75 për qind, me bazë vjetore, më e ulët se interesi i marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor, që përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

(3) Nëse Banka e Shqipërisë vendos të ndryshojë normën e interesit për depozitën njëditore, atëherë ajo njofton menjëherë bankat e nivelit të dytë për ndryshimin e bërë.

Neni 5

(1) Banka e nivelit të dytë vendos depozitë njëditore duke transferuar fondet në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet Sistemit të Shlyerjeve Bruto në Kohë Reale (RTGS).

(2) Banka e Shqipërisë pranon depozita nga bankat e nivelit të dytë 15 minuta përpara *cut-off* përfundimtar, të vendosur në rregulloren "Rregulla dhe procedura të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare – AIPS" miratuar me vendimin nr. 103, datë 10.12.2003, të Këshillit Mbikëqyrës.

(3) Ditën vijuese të operimit të sistemit të pagesave AIPS, Banka e Shqipërisë i transferon bankës së nivelit të dytë maturimin dhe interesin e depozitës në kohën e përcaktuar në

rregulloren "Rregulla dhe procedura të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare – AIPS".

Neni 6

Kjo rregullore miratohet me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.58, datë 13.07.2005 dhe hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 7

Me miratimin e kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja "Për depozitën njëditore" miratuar me vendim nr.08, datë 07.02.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Ardian FULLANI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 59, datë 13.07.2005

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KREDINË NJËDITORE**

Në mbështetje të neneve 1,14,15,16,18, si dhe nenit 43, shkronjat (a) dhe (c) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për kredinë njëditore”, sipas tekstit që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare, për zbatimin e këtij vendimi dhe për dërgimin e kësaj rregulloreje në bankat e nivelit të dytë.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për botimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Vendimi nr.29, datë 28.04.2004 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për kredinë njëditore”, shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**RREGULLORE
PËR KREDINË NJËDITORE**

Neni 1

Kredia njëditore përfaqëson një instrument afatshkurtër borxhi në dispozicion të bankave të nivelit të dytë. Ajo është një kredi plotësisht e garantuar, e cila ka për qëllim të shtojë likuiditetin në sistemin bankar dhe të ndihmojë në administrimin e normave afatshkurtra të interesit.

Neni 2

Banka e Shqipërisë akordon kredi njëditore për bankat dhe për degët e bankave që kanë llogari në Bankën e Shqipërisë.

Neni 3

(1) Bankat e nivelit të dytë që vlerësojnë se nga aktiviteti i tyre ditor rezultojnë me mungesë likuiditeti, bëjnë kërkesë pranë Bankës së Shqipërisë për akordimin e kredisë njëditore me shkresë zyrtare, nëpërmjet faksit, me SWIFT ose nëpërmjet sistemit REUTERS.

(2) Banka e Shqipërisë akordon kredi njëditore automatike për bankat e nivelit të dytë për rastet e parashikuara në rregulloren "Mbi kredinë brenda ditës" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.20, datë 24.03.2004.

(3) Banka e Shqipërisë mund të refuzojë kërkesën e bankave të nivelit të dytë për akordim të kredisë njëditore në përputhje me synimet e saj, pa dhënë shpjegime.

Neni 4

Për garantimin e kredisë njëditore shërbejnë rregullat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren " Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë", miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.107, datë 24.12.2003.

Neni 5

(1) Norma e kredisë njëditore, që aplikon Banka e Shqipërisë, sinjalizon nivelin e dëshirueshëm tavan, të normave afatshkurtra të interesit, që aplikohen në tregun ndërbankar.

(2) Norma e interesit të kredisë njëditore është 1.75 për qind, me bazë vjetore, më e lartë se interesi i marrëveshjeve të riblerjeve, që përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

(3) Banka e Shqipërisë njofton menjëherë bankat për çdo ndryshim të normës së interesit.

Neni 6

(1) Banka e Shqipërisë akordon kredinë njëditore automatike ose kredinë njëditore me kërkesë të bankës së nivelit të dytë, duke transferuar fondet në llogarinë e bankës përkatëse.

(2) Ditën vijuese të operimit të sistemit të pagesave AIPS, banka e nivelit të dytë shlyen kredinë njëditore së bashku me interesin, duke transferuar fondet në Bankën e Shqipërisë në kohën e përcaktuar në rregulloren "Rregulla dhe procedura të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare – AIPS".

(3) Për çdo rast të akordimit të kredisë njëditore, Departamenti i Operacioneve Monetare njofton Departamentin e Mbikëqyrjes.

Neni 7

Nëse banka e nivelit të dytë nuk mund të gjejë fonde të mjaftueshme për kthimin e kredisë, atëherë rregullat mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë, të përcaktuar në rregulloren përkatëse, gjejnë zbatim të menjëhershëm të pakushtëzuar.

Neni 8

Kjo rregullore miratohet me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.59, datë 13.07.2005 dhe hyn në fuqi me botimin në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 9

Me miratimin e kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja "Për kredinë njëditore" miratuar me vendim nr.08, datë 07.02.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Ardian FULLANI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 60, datë 13.07.2005

**PËR
VENDOSJE KOMISIONI NË SPORTELET
E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR BONOT E THESARIT**

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, neni 43 gërma "g", "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Banka e Shqipërisë të vendosë komision për shërbimin që u afron individëve në sportelet e saj.
2. Komisioni të llogaritet mbi bazën e kostos marxhinale dhe të jetë i njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit në tregun primar të bonove të thesarit. Si bazë për logaritjen e komisionit do të shërbejnë shpenzimet e kryera në sportelin e bonove të thesarit në Tiranë. I njëjti komision do të përdoret edhe në sportelet e degëve të Bankës së Shqipërisë në rrethe.
3. Autorizohen administratorët e Bankës së Shqipërisë të miratojnë komisionin, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave, si dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.09.2005.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005

1. Vendim nr.01, datë 26.01.2005 “Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2004”.
2. Vendim nr.02, datë 26.01.2005 “Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri”.
3. Vendim nr.03, datë 26.01.2005 “Për një ndryshim në rregulloren “Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë””.
4. Vendim nr.04, datë 26.01.2005 “Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave”.
5. Vendim nr.08, datë 26.01.2005 “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë”.
6. Vendim nr.09, datë 26.01.2005 “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë”.
7. Vendim nr.10, datë 26.01.2005 “Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005

1. Vendim nr.11, datë 09.02.2005 “Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes”.
2. Vendim nr.12, datë 09.02.2005 “Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar “Union Bank” sh.a.”.
3. Vendim nr.13, datë 09.02.2005 “Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë”.
4. Vendim nr.14, datë 09.02.2005 “Për miratimin e rregullores për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005

1. Vendim nr.15, datë 23.02.2005 “Për miratimin e Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2005”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005

1. Vendim nr.18, datë 09.03.2005 “Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtimore, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005”.
2. Vendim nr.19, datë 09.03.2005 “Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto në Bankën e Shqipërisë”.
3. Vendim nr.22, datë 09.03.2005 “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës të Bankës së Shqipërisë”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005

1. Vendim nr.24, datë 30.03.2005 “Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë”.
2. Vendim nr.27, datë 30.03.2005 “Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006”.
3. Vendim nr.28, datë 30.03.2005 “Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005

1. Vendim nr. 30, datë 27.04.2005 “Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin mars të vitit 2005”.
2. Vendim nr. 31, datë 27.04.2005 “Për një ndryshim në rregulloren për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”.
3. Vendim nr. 32, datë 27.04.2005 “Për miratimin e sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare”.

4. Vendim nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 01.04.2003 për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
5. Vendim nr. 35, datë 27.04.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat dhe shpenzimet e daljes jashtë shtetit për shërbim, kualifikim etj., të punonjësve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005

1. Vendim nr. 36, datë 19.05.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat e shtypjes, rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 38, datë 19.05.2005 "Për miratimin e rregullores mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore".
3. Vendim nr. 40, datë 19.05.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim nr. 41, datë 19.05.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005

1. Vendim nr. 42, datë 08.06.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 43, datë 08.06.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe unioneve të tyre".
3. Vendim nr. 44, datë 08.06.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre".
4. Vendim nr. 45, datë 08.06.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim nr. 46, datë 08.06.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për mjaftueshmërinë e kapitalit".

6. Vendim nr. 47, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga fondet për rindërtimin e Kosovës tek Fonds der Republik der Kosova, Gjermani".
7. Vendim nr. 48, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga Fonds der Republik der Kosova, Gjermani tek Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese (Banka Popullore Pulieze)".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005

1. Vendim nr. 49, datë 29.06.2005 "Për miratimin e "Raportit të Politikës Monetare për muajin maj të vitit 2005"".
2. Vendim nr. 51, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)"".
3. Vendim nr. 52, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
4. Vendim nr. 53, datë 29.06.2005 "Për "miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH"".
5. Vendim nr. 54, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS"".
6. Vendim nr. 55, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS"".